



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Prudatu Received / Delivery	07-02-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shifra e Lartëq. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAK/SHK	588/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1212/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1212/2021 të datës 23.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Gjilanit, kundër Vendimit me Nr.Ref 2112/1460/KPM/xh.1 të datës 15.12.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave, në çështjen juridike “Pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1212/2021 e datës 23.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Ref.2112/1460/KPM/xh.1 i datës 15.12.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Ankuesi Kryeshf Ekzekutiv i Zyrës Ekzekutive në Komisionin e Pavarur të Mediave (me tutje referuar si KPM), me datën 23.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6300/2021 të regjistruar me numër A.nr.1212/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.2112/1460/KPM/xh.1 të datës 15.12.2021 të Kryetarit të KPM-së, lidhur me vazhdimin e masës se pezullimit parandalues me 50% të pagës, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin



e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën me numër të protokollit 6417/2021 për përgjigje në ankesë të KPM-ja, ndërsa me datë 14.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokollit 6300/2021 të regjistruar me numër A.nr.1212/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.2112/1460/KPM/xl të datës 15.12.2021 të KPM-së; Kërkesën e datës 25.11.2021; Vendimin me numër 2107/771/KPM/xh.l të datës 02.07.2021; Vendimin me numër Ref;1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6417/2021 të datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 162/2022; Vendimin me numër të protokollit 3373/2021 të datës 29.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 18.01.2022 me numër të protokollit 206/2022 drejtuar Administratores së Prokurorisë Themelore në Prishtinë; Emalin e datës 17.01.2022 të pranuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, gjegjësisht Vendimin me numër Ref:1909/1054/KPM/mf të datës 16.09.2019 të KPM-së është konstatuar se ankuesi me datë 16.09.2019 është emëruar në pozitën e punës *Kryeshef Ekzekutiv i Zyrës Ekzekutive* në kuadër të KPM-së, me mandat katër (4) vjeçar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Kryetari i KPM-së, me datë 02.07.2021 ka nxjerr Vendimin me numër Ref:2107/771/KPM/xh.l përmes të cilit ka pezulluar ankuesin nga ushtrimi i detyrës me kompensim 50% të pagës, deri në një vendim tjetër, me arsyetimin se ndaj të njëjtit është iniciuar procedurë penale dhe është shqiptuar masa e paraburgimit.

Ankuesi, me datë 25.11.2021 i është drejtuar me kërkesë Kryetarit të KPM-së, për anulimin e Ref:2107/771/KPM/xh.l të datës 02.07.2021 për pezullim parandalues dhe i njëjti ka kërkuar të kthehet në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, me arsyetimin se me datë 22.11.2021 i ka përfunduar masa e arrestit shtëpiak dhe se gjykata kompetente nuk ka lëshuar ndonjë masë tjetër e cila do të kufizonte lirin e lëvizjes.

Me datë 15.12.2021 KPM ka nxjerr Vendimin me numër Ref.2112/1460/KPM/xh.l me të cilin ankuesit i është vazhduar masa e pezullimit të ushtrimit të detyrave me të drejtën e kompensimit në pagë në lartësi prej 50% të pagës me arsyetimin se ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të anulohet vendimi për pezullim parandalues për faktin se ndaj palës është duke u zhvilluar procedurë penale.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.Ref.2112/1460/KPM/xh.l të datës 15.12.2021 të KPM-së, me datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, sepse i njëjti pretendon se vendimi për pezullimin e tij është në kundërshtim me nenin 53.1 dhe 54.1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe se gabimisht është zbatuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, sepse sipas ankuesit me nenin 85 të

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil dhe çdo dispozite tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë.* Ndërsa në pikën II të këtij aktgjykimi është konstatuar se neni 85 i Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk është në përputhshmëri me nenin 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kushtetutës. Andaj, në kuptim të këtij aktgjykimi Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se Ligji nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nuk zbatohet në raport me Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe rrjedhimisht Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në raport me Komisionin e Pavarur të Mediave, ka mbetur në fuqi, deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit material është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht emailin e datës 18.01.2022 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka gjetur se Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Renda, me datë 13.09.2021 ka ngritur Aktakuzën PP.I.39K/2021, ndaj ankuesit, lidhur me kryerjen e veprës penale nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Andaj, duke marr parasysh faktin se ndaj ankuesit është ngritur aktakuzë dhe rrjedhimisht është duke u zhvilluar procedurë penale për veprë penale nga neni 421 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Kolegji vlerëson se vendimi me numër Ref.2112/1460/KPM/xh.1 i datës 15.12.2021 i KPM-së për pezullimin e ankuesit nga ushtrimi i detyrave të punës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata është në pajtim me nenin 75 ndërlidhur me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se Nëpunësit civil pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse kundër tij/saj është inicuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marr 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në raport me vendimin e kontestuar për shkak të shkeljeve materiale, është i pabazuar.

Rrjedhimisht, Kolegji konstaton se edhe pretendimi ankimor i ankuesit se Vendimi Ref.2112/1460/KPM/xh.1 i datës 15.12.2021 i KPM-së është nxjerr në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe 54 paragrafi 1 nën paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i pabazuar, sepse ashtu siç është cekur me lartë Kolegji vlerëson se Ligji



Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës është i zbatueshëm në raport me Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe se vendimi i kontestuar ka mbështetje ligjore në dispozitat e këtij Ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1212/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komisionit të Pavarur të Mediave;
- Udhëheqësit të Personelit në Komisionin e Pavarur të Mediave; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.